

GJL nr.1221//2012

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dok. No.	Nr. Prot.
Dok. No. DPK/DMP	Nr. Prot. 03-4273/12
Dok. No. 02	Dat. 26.11.2012

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarëve: Ragip Namani kryetar, Dalip Bega dhe Ramiz Kuqi anëtarë, me pjesëmarrjen e sek. juridike Ganimete Dumani, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Agjencioni Kundër Korrupsionit, kundër aktvendimit të Gjykatës komunale për kundërvajtje në Klinë, Regj.I.nr.4101/2012, të dt. 08.10.2012 e në bazë të neneve 31 al.3, 39 dhe 222 të Ligjit mbi kundërvajtjet, me 06.11.2012, nxjerr:

AKTVENDIM

Ankesa e paraqitur është e **BAZUAR**.

ABROGOHET aktvendimi i Gjykatës komunale për kundërvajtje në Klinë, Regj.I.nr.4101/2012, i dt 08.10.2012, dhe lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në plotësim të procedurës dhe rivendosje.

Nga një kopje e këtij aktvendimi u dorëzohet palëve.

Arsyetim

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Klinë, me aktvendimin Regj.I.nr.4101/2012, të dt.08.10.2012 të pandehurin Izver Dauti, nga fsh.Shtupel K. Klinë, e ka shpallë përgjegjës sepse nuk e ka bërë deklarin e rregullt vjetor të pasurisë në Agjencionin kundër korrupsionit si Zyrtar i Lartë Publik gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik, Këshilltarë Komunal edhe pse ka qenë i obliguar që ta bëjë për vitin 2012 prej datës 1 deri me 31 Mars, me ç, veprim ka bërë kundërvajtje nga neni 6.1.1 e dënueshme sipas nenit 17.1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtar, për të cilën kundërvajtje, konform nenit 9 të Ligjit për Kundërvajtje ia shqiptoi gjobën në shumë prej 180€. Me të njëjtin aktvendim i pandehuri është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 5€

Kundër këtij aktvendimi ankesë ka paraqitur Agjencioni Kundër Korrupsionit, për shkak të: vendimit mbi dënimin, në arsyetim të ankesës përpos tjerash theksohet se: gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar dënim me gjobë prej 180€ duke u thirur në nenin 17 par. 1 pika 1 si dhe nenin 9 të Ligjit për Kundërvajtje, se dënimi i cili i është shqiptuar është në kundërshtim me nenin 17 par.1 pika 3 të Ligjit 04/L-050, edhe pse AKK në kërkesën e saj ka bërë kualifikimin juridik në pajtim me Ligjin e lartpërmendur, se nga gjykata dënimi është zbutur në masë të madhe në vështrim të nenit 9 të Ligjit për Kundërvajtje e që është në kundërshtim me rregullat mbi zbutjen e dënimit, andaj nga të lartcekurat propozon që aktvendimi i goditur të abrogohet dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje dhe të pandehurit ti shqiptohet dënimi meritor në pajtim me ligjin 04/L-050.

Kolegji vlerësoi thëniet në ankesën e paraqitur, aktvendimin e goditur, por duke u bazuar edhe në shkresat tjera të lëndës, ankesën e paraqitur nga AKK e aprovoi si të bazuar, kurse aktvendimi i goditur abrogohet dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kolegji vendosi për abrogimin e aktvendimit të atakuar për shkak të shkeljes së dispozitave esenciale të procedurës kundërvajtëse dhe për shkak të vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike.

2.

Gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë aktvendim në kundërshtim me kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse. Kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse e AKK-së, e ngarkon të pandehurin për mos deklarim të pasurisë nga neni 5 neni 6, par.1.3 dhe nga neni 9 të Ligjit 04./L-050, dhe në përshkrim të kundërvajtjes i propozon gjykatës që i pandehuri të shpallet fajtor dhe të ndëshkohet sipas nenit 17 par.1 .3 të njëjtit Ligj, nga kjo rezulton se kërkesa e AKK-së të pandehurit i ngarkon kundërvajtjen për mos **deklarim të pasurisë sipas kërkesës së Agjencisë**, neni 6 par.1.3 neni 9 i të njëjtit Ligj sqaron se i pandehuri nuk ka vepruar për të deklaruar pasurinë sipas kërkesës së Agjencisë, ku propozohet që ti shqiptohet dënimi sipas nenit 17 par.1.3 të njëjtit Ligj, ndërsa i pandehuri është shpallur përgjegjës për **“mos deklarim të rregullt vjetor të pasurisë në AKK** edhe pse ka qenë i detyruar që ta deklaroi pasurinë deri më datën 31.03.2012”, në vështrim të nenit 6.1.1 dhe 17 par.1.1 të Ligjit 04/L-050 dhe në vështrim të nenit 9 të Ligjit për Kundërvajtje, e që është në kundërshtim me atë për çka e ngarkon kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse.

Vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike ka të bëjë me faktin se i pandehuri në deklaratën e tij të dhënë në gjykatë të shkallës së parë në procesverbal të dt 24.09.2012, nuk është sqaruar në mënyrë të plotë se për cilën veprë kundërvajtëse është marr në pyetje (për atë çka ngarkohet në kërkesë të AKK-së deklarim i pasurisë sipas kërkesës së Agjencisë apo për deklarim të rregullt të pasurisë”, nuk dihet koha se kur e ka pranuar formularin për deklarim të pasurisë dhe afati që është dashur të respektoi për dorëzim të formularit në AKK andaj nga shkaqet e cekura më latë aktvendimi si i tillë është i pa qëndrueshëm dhe nga Kolegji abrogohet dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në plotësim të procedurës dhe rivendosje.

Në plotësim të procedurës, gjykata e shkallës së parë duhet të veproi sipas konstatimeve dhe vërejtjeve të theksuara më lartë të Kolegjit , të merr në pyetje përfaqësuesin e ushtruesit të kërkesës i cili (bazuar në kërkesën e ushtruar) duhet të dëshmoi se kur dhe për çka ka kërkuar nga i pandehuri që të bëjë deklarimin e pasurisë si në vështrim të nenit 6 par. 1.3, neni 9 dhe neni 17 par.1.3 të Ligjit nr. 04/L-050, pasi që kërkesa e tyre nuk ka përshkrim të kundërvajtjes me fjalë ashtu siç është e paraparë me nenin 135 pika 2 të Ligjit për Kundërvajtje, dhe pas sqarimit të çështjes me AKK të merret në pyetje përsëri i pandehuri i cili duhet të deklarohet në bazë të pretendimeve dhe ngarkesës sipas kërkesës së AKK-së. Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të këtyre provave dhe provave tjera eventuale të nevojshme e duke i pasur parasysh edhe thëniet në ankesën e paraqitur nga AKK dhe varësisht prej vërtetimit të gjendjes faktike të nxjerr aktvendim të drejtë të bazuar në prova dhe ligj.


Nga të lartcekurat konform të nenit 222 të LMK u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË,

GJLnr.1221/2012, dt. 06.11.2012.

SEK. JURIDIKE
Ganimete Dumani



KRYETARI I KOLEGJIT

Ragip Namani

